

TERMAT E REFERENCËS

MARRVESHJE KUADER

MBESHTETJE PER PROGRAMIN 2024 - 2026

**SHËRBIME PROJEKTIMI
LOT 4**

Pasqyra Përmbledhëse

1	Objekti i Punes	3
2	Lot 4: Terma Reference.....	4
2.1	Elementet e Detyres se Projektimit	4
2.2	Përgatitja e ToR - Detyra Projektimi.....	5
2.2.1	Analiza e detyrës së projektimit.	5
2.2.2	Projekt idea paraprake.....	6
2.2.3	Projektidea përfundimtare	6
2.2.4	Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit.....	6
2.2.5	Projekti i zbatimit	7
2.2.6	Përgatitja e dokumentacionin për procedurë tenderimi	7
2.2.7	Preventivi përfundimtar.....	8
2.2.8	Specifikimet teknike.....	8
2.2.9	Grafiku i punimeve.....	8
3	KRITERET E PROJEKTIMIT	9

1 Objekti i Punes

Shtrirja e objektit te punes do te behet sipas Lot-eve te meposhtme, fazat e projektimit do te percaktohen ne fazen e II-te te minikonkurseve dhe jo domosdoshmerisht do te perfshihen te gjitha sherbimet e cituara ne LOT-et e dhena. Ne fazen e minikonkurseve paketat do te percaktohen sipas nevojës se sherbimit qe kerkohet per faza specifike.

Lot 4: Hartimin e masterplaneve dhe sistemeve, dhe/ose projekteve teknologjike, dhe/ose projekteve te detajuara, dhe/ose përgatitje të termave të referencës, dhe/ose përgatitje të dokumenteve për tenderim, për objekte industriale, tekonologji, informacion, objekte ekologjike miqësore me mjedisin, bio-teknologjike, me eficencë energjie, industriale, mekanike, impiante, sinjalistike, kontrolle aksesi, sisteme të automatizuara, impianti trajtimi ujrash, përpunim bimesh medicinale, përpunim qumështi, blegtori, bujqësi etj.

2 Lot 4: Terma Reference

Lot 4: “Hartimin e masterplaneve, dhe/ose projekteve teknologjike, dhe/ose projekteve te detajuara, dhe/ose përgatitje të termave të referencës, dhe/ose përgatitje të dokumenteve për tenderim, për objekte industriale, teknologji, informacion, objekte ekologjike miqësore me mjedisin, bio-teknologjike, me efikasitet energjie, industriale, mekanike, impiante, sinjalistike, kontrolle aksesi, sisteme të automatizuara, impianti trajtimi ujrash, përpunim bimesh medicinale, përpunim qumështi, blegtori, bujqësi etj.”

Shërbimet për sistemet teknike përfshijnë projektin teknik, si pjesë e projektit të përgjithshëm.

Sistemet teknike dhe teknologjike përfshijnë impiantet e mëposhtme si:

- Sistemit të gazit, ujrave të bardha dhe ujrave të zeza;
- Sistemit të ngrohjes, prodhimit;
- Sistemit të ventilimit;
- Sistemit të tensionit të ulët, të mesëm dhe të lartë;
- Sistemeve të telekomunikacionin dhe procesimin e të dhënave;
- Sistemit transportues;
- Sistemit me një qëllim të caktuar, duke përfshirë sistemin TIK, mekanikë dhe elektroteknikë në objektet civile inxhinierike;
- Sistemet e automatizimit;
- Sistemet matjes kontrollit transmetimit të të dhënave dhe komandimit (sistemi SCADA).

Tipologjia për sistemet teknike përfshin shërbimet e siguruar nga ofruesi i tyre në lidhje me sistemet e reja, rindërtime, zgjerime, shndërrime, proceset e modernizimit, të mirëmbajtjes dhe riparimit.

2.1 Elementet e Detyres se Projektimit

Shërbimet e kërkuara duhet të jenë në përputhje me VKM 354, datë 11.05.2016.

Elementet e projektit janë më poshtë:

- Përgatitje ToRs;
- Analiza e detyrës së projektimit,;
- Projekt - ideja paraprake;
- Projekt - ideja përfundimtare;
- Projekti për lejen e ndërtimit;
- Përgatitje Dokumenta Tenderi;
- Projekti i detajuar i zbatimit;

Grupi i konsulencës do të përqëndrohet në kryerjen e këtyre detyrave, por pa u kufizuar vetëm në to:

2.2 Përgatitja e ToR - Detyra Projektimi

Përgatitja e ToRs të projektimit për masterplane dhe projektet teknike, duhet të përfshij por pa u kufizuar në:

- Qëllimin e ndërhyrjes së propozuar dhe objektivat e kerkuara nga realizimi i vepres ndertimore;
- Objektin e punës së detyrës së projektimit, të kërkuar kundrejt projektuesit sipas tipologjise së ndërhyrjes;
- Përcaktimin e fazave të detyrës së projektimit, Vlerën e Investimit, të ndara në kategori të veçuara për masterplane dhe projekte teknike;
- Detajimin e çdo kërkesë për çdo fazë, referuar vizatimeve, hartografive, specifikimeve teknike, preventivave dhe raporteve teknike, territoriale, gjeodezike, gjeologjike, mjedisore, hidrologjike, sismologjike, mekanike, elektrike, KUB KUZ, ujësjes dhe të sistemeve TIK etj.;
- Kushte dhe standarde të projektimit referuar disiplinave specifike të projektimit;
- Përcaktimin e standardeve, formateve të vizatimit të projektimit, formateve dhe kërkesave specifike të raporteve dhe specifikimeve teknike;
- Kërkesave specifike për realizimin e raporteve dhe të analizave territoriale të pronësisë mbi truallin;
- Përckatimin e formave dhe kërkesave të dorëzimit të materjaleve për çdo fazë;
- Kërkesave të përcaktimit të mjeteve teknike dhe numrit të punonjësve të angazhuar;
- Kohës së realizimit të projekteve, formateve të dorëzimit dhe gjuhëve të zgjedhura për shkrimin e dokumentave dhe realizimin e projektit. Elementët e produkteve të projektimit

2.2.1 Analiza e detyrës së projektimit.

Gjetja e kushteve për zgjidhjen teknike të detyrës nëpërmjet planifikimit.

Shërbime bazë.

- Sqarimi i shtrimit të detyrës dhe nevojës në fushën e pajisjeve teknike, teknologjike dhe të sistemeve në marrëdhëniet me porosidhënesin dhe planifikuesin e objektit të punës, në mënyrë të veçantë në principet teknike dhe të rentabilitetit e përfitueshmërisë.
- Përmbledhja e rezultateve

Shërbime të veçanta

- Analiza e sistemit (sqarimi i sistemeve të mundshme sipas dobisë, punës, rentabilitetit dhe realizueshmërisë dhe pajtueshmërisë me ambientin).

- Përmbledhja e të dhënave, analiza dhe procese optimimi, p.sh. për kursimin e energjisë dhe pajtueshmërinë me ambientin

2.2.2 Projekt idea paraprake

Përgatitja për projektim dhe për planifikim. Përpunimi pjesëve të rëndësishme të një zgjidhjeje të detyrës së planifikimit

Shërbime bazë.

- Përpunimi i një koncepti, masterplani, sistemi apo skemave teknologjike si dhe planifikimit fazave të zhvillimit të tyre me spjegime të përafërta të sistemeve dhe pjesëve më të rëndësishme të impianteve përfshirë studimin e zgjidhjeve të mundshme alternative sipas kërkesave të njëjta të objektit me paraqitje skematike, vizatime dhe skema për integrimin në planifikimin e objektit përfshirë parastudimin e rentabilitetit/përfitueshmërisë.
- Hartimi i skemave të funksionimit ose figurave të vënies në funksionim të çdo impianti.
- Sqarimi dhe spjegimi i lidhjeve themelore specifike të fushës, proceseve dhe kushteve.
- Bashkëpunim në bisedimet paraprake me autorite dhe të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikimin e aftësisë për t'u miratuar.
- Bashkëveprim për vlerësimin e shpenzimeve dhe rentabilitetit .
- Grumbullimi i rezultateve të paraplanifikimit.

Shërbime të veçanta

- Përpunimi i të dhënave për planifikimin e të tretëve, p.sh. për teknikën qendrore të dritës.
- Dëshmi e detajuar dhe apo skeda teknike për rentabilitetin ekonomik dhe teknologjik.
- Raporte krahasimi të detajuar për emisionet e lëndëve të dëmshme.
- Llogaritjet e shpenzimeve të prodhimit.
- Llogaritjet e emisioneve të lëndëve të dëmshme.
- Hartimi i pjesës teknike të një dokumenti referuar strukturave dhe godina ku instalohen mjetet, impjantet, sistemet apo platformat si kontribut për përshkrimin e punës;

2.2.3 Projektidea përfundimtare

Sistemet dhe integrimi i tyre në projekt

Shërbime bazë

- Përpunimi i konceptit të planifikuar (përpunimi hap pas hapi i një zgjidhjeje teknike me dokumentacion skema, rrjete, vizatime hartografike , apo gjuhe programimi për sisteme e platforma) duke patur parasysh të gjitha kërkesat specifike të fushës si dhe duke respektuar të gjitha planifikimet e specialitetit të integruara në planifikimin e objektit deri në projekt-idene e plotë.
- Përcaktimi i të gjitha sistemeve dhe pjesëve të Impianteve, që përfshijnë mjetet, pajisjet primare dhe sekondare, rrjetet dhe apo programet e nevojshme digitale.
- Raportet e Llogaritjes dhe matjeve si dhe paraqitja e përshkrimit të impianteve
- Dhënia dhe akordimi i të gjitha veprimeve të nevojshme për planifikimin e strukturës mbajtëse dhe të dhënat për ngarkesëm (pa përgatitjen e planit çarjeve dhe prishjeve apo demtimeve).
- Bashkëpunim në bisedimet me autoritet dhe të tjerë, që pjesë e strukturave miratuese. Bashkëpunim në llogaritjen e shpenzimeve.

- Perlllogaritjen në kontrollin e shpenzimeve duke krahasuar llogaritjen e shpenzimeve me vlerësimin e perfitueshmerisë.

2.2.4 Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit.

Shërbime bazë

- Përpunimi i dokumentave të nevojshme sipas dispozitave ligjore publike për lejet ose aprovimet e nevojshme përfshirë kërkesat për përjashtime dhe lirime si dhe grumbullimi i këtyre dokumentave pas bisedimeve të nevojshme me autoritetet.
- Plotësimi dhe përshtatja e dokumentave të planifikimit për zhvillimin e impjanteve, sistemeve dhe apo platformave ,bazuar ne kerkesat per ndryshim te institucioneve bazuar ne përshkrimet edhe llogaritjet

Shërbime të veçanta

- Kontrolli dhe pranimi i skemave të funksionimit të planifikuesit të strukturës mbajtëse dhe vizatimeve të montimit për përputhshmërinë me planifikimin e projektit të sistemit, impjantit, platformes apo rrjeteve.
- Përgatitja e planeve, e mjeteve dhe burimeve njerezore të ndërmarrjes dhe makinave të vëna në dispozicion nga të tjerë, në mënyrë që të mund të zhvillohet projekti i sistemit, impjantit dhe apo platformes.
- Përgatitja e projekteve e planeve ndihmese të linjave elektrike, TIK dhe infrastruktures kritike për lidhjen e impjanteve dhe sistemeve me mjete pajisje dhe teknologji ekzistuese.

2.2.5 Projekti i zbatimit

Shërbime bazë

- Përpunimi i detajuar i projektit sipas rezultateve të fazave të mëparshme (përpunimi hap pas hapi i paraqitjes së zgjidhjes) duke repektuar planifikimet e specialitetit të integruara nëpërmjet planifikimit të objektit.
- Realizimi i raporteve teknike e teknologjike, projektit të skedave teknologjike e teknike, specifikimeve teknike,grafikut të punimeve, preventivit të zbatimit;
- Paraqitje vizatimore e impianteve (pajisjeve dhe teknologjive) me dimensione (vizatime për montimin dhe punishten).
- Përgatitja e planeve për hapje dhe prishje për implementimin në objekt.
- Përditësimi dhe plotësimi i vazhdueshëm dhe i detyruar i vizatimeve për zhvillimin e produktit të plotë që garanton ofrimin e shërbimit të kërkuar nga klienti.

Shërbimet e veçanta

- Kontrolli dhe pranimi i skemave të funksionimit të planifikuesit të strukturës mbajtëse dhe vizatimeve të montimit për përputhshmërinë me planifikimin,
- Përgatitja e planeve për bashkimin e mjeteve të ndërmarrjes dhe makinave të vëna në dispozicion nga të tjerë.
- Përgatitja e planeve të linjave elektrike TIK dhe infrastrukturave të tjera kritike

2.2.6 Përgatitja e dokumentacionin për procedurë tenderimi

Shërbimet bazë:

- Përmbledhja e dokumenteve të dhënies për të gjitha fushat e punës.

- Verifikimi dhe vlerësimi i termave të referencës përfshirë hartimin e dokumentacionit për prokurim.
- Akordimi dhe përmbledhja e punimeve të atyre që marrin pjesë profesionalisht, të cilët bashkëpunojnë gjatë dhënies së dokumentave.
- Llogaritja e shpenzimeve.
- Bashkëveprim gjatë dhënies së ofertës.

Shërbimet e veçanta:

- Kontrolli i vlerave të ofertave nga përshkrimi i shërbimeve me program të shërbimeve përfshirë pasqyrën e çmimeve. ¹⁾
- Hartimi, kontrolli dhe vlerësimi i pasqyrave të çmimeve sipas kërkesave të veçanta

2.2.7 Preventivi përfundimtar

Preventivi për zbatimin e projektit (bazuar në VKM No.2. date 08.05.2003. “Mbi klasifikimin dhe strukturën e kostos në ndërtim”);

- Analizë teknike e çmimeve për të gjitha punimet e vlerësuara në preventivë të bazuar në **VKM nr.216, 13.04.2023 “Sistemi i Integruar i Manualit Të Çmimeve Në Ndërtim”**:
- Zërat e punimeve që nuk janë të përfshira në manualin teknik të çmimeve në fuqi, duhet të shoqërohen me zërbërthimin e çmimit (analizën përkatëse) dhe t'i bashkëngjiten vlerësimit.
- Vlera e preventivit përfundimtar nuk duhet të tejkalojë vlerën e përlogaritur të investimit (më lartë: Tabela e vlerësimit të kostos)

2.2.8 Specifikimet teknike

Kontraktuesi duhet të përgatisë specifikimet teknike për secilën material që do të përdoret. Për secilën punë të përfshirë në preventiv, duhet të bëhet analiza sipas kësaj skeme:

- Përshkrimi i detajuar i procesit të punës;
- Metoda e vendosjes;
- Cilësia e kërkuar;
- Format e miratuara;
- Ngjyra e rekomanduar;
- Njesia matëse
- etj

Konsulenti duhet të ketë parasysh se për të gjitha specifikimet e materialeve nuk duhet të përcaktojë emrin e kompanisë që i prodhon.

2.2.9 Grafiku i punimeve

Grafiku i punimeve duhet të përgatitet bazuar në specifikimet e produkteve dhe teknologjinë e punës.

3 KRITERET E PROJEKTIMIT

Lot 4: "Hartimin e masterplaneve, projekteve teknologjike, projekteve te detajuara, pergatitje te termave te references si dhe dokumenta tenderi objekte industriale, tekonojgi, informacion, objekte ekologjike miqesore me mjedisin, bio-teknologjike, me eficence energjie, industriale, mekanike, impiante, sinjalistike, kontrole aksesi, sisteme te automatizuara, impianti trajtimi ujrash, perpunimi bimesh medicinale, perpunim qumeshti, blegtori, bujqesi etj.

Licensat e kerkuara ne projektim:

- 2 a: Projektim arkitekturor për objekte banimi - objekte industriale;
- 3 a,b-2,d: Projektim objekte civile – industrial – turistike, prej murature dhe skelet beton arme deri ne 5 kate; objekte me skelet metalik; Vleresim kapaciteti mbajtese dhe perforcimi i strukturave mbajtese prej beton-arme, murature dhe metalike.
- 4 a,b,c,f,g,j: Projektim të instalimeve hidro-termosanitare; Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme; Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale; Projektim të sistemeve kundra zjarrit; Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa, Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale.
- 8 a: Projektim gjeodet per rlevime inxhinerike.
- a) Licence, Grupi 2 - Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis, Nenkategoria: Veprimtarite e ekspertizes lidhur me vleresimin e ndikimit ne mjedis-Kodi: III.2A

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti operatori ekonomik duhet te paraqese licensen e shoqerise.

- b) Operatori Ekonomik ose bashkimi i Operatoreve Ekonomike duhet te paraqesin nje liste te stafit kryesor te meposhtem, te cilet duhet te kene nje marredhenie kontraktore me operatorin apo partneret ne rastin e nje bashkimi operatoresh. I gjithe stafi kryesor i kerkuar duhet te jete i licensuar ne sherbimet e projektimit dhe duhet te zoteroje licensat profesionale sipas kategorive e renditura me poshte, perkatesisht per specialitetin qe mbulojne. Per çdo pozicion, operatoret jane te lire te propozojne me shume se nje kandidat, me qellim permbushjen e kriterëve te kerkuara. Pozicionet e stafit kryesor te kerkuar jane:

Stafi per sherbimin e projektimit :

- a. Drejtues Projekti (Drejtues i grupit te projektimit) – Projektues instalator
- b. Arkitekt
- c. Projektues Konstruktore
- d. Projektues gjeodet
- e. Specialit mjedisi

Per stafin e mesiperm duhet te paraqiten kontratat e punes apo marreveshjet e bashkepunimit. Per te vertetuar pervojen ne pune duhet te paraqiten CV me firme nga vete personi dhe administrator dhe vertetime per realizimin te leshuar nga operatori.

Licensat qe duhet te zoteroje stafi kryesor:

Drejtues Projekti (Drejtues i grupit te projektimit)	4 a,b,c,f,g,j
Arkitekt	2 a
Projektues Konstruktore	3 a,b-2,d
Projektues Gjeodet	8 a
Specialisi i Mjedisit: Duhet te zoteroje License	Grupi 2, Kodi: III.2 A- Rregjistrim ne QKB

- Drejtues Projekti Projektues Instalator, Arkitekt, Projektues Konstruktore, duhet te jene pjese e stafit te shoqerise dhe te figurojne ne listepagesat e punonjesve te shoqerise per periudhen Shkurt - Prill 2024
- Numri i punonjesve: Numri mesatar i punonjesve te siguruar duhet te jetë jo më pak se 4 (katër) punonjës për periudhën Shkurt - Prill 2024, e vërtetuar kjo me listëpagesat përkatëse të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve;

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.